

## Titulli i lëndës: **Gjuhësi ballkanike**

| Informatat themelore për lëndën |   |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike:               | Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës shqipe   |
| Titulli i lëndës:               | Gjuhësi ballkanike  |
| Niveli:                         | Master  |
| Statusi i lëndës:               | Obligative  |
| Viti i studimeve:               | Viti I, semestri I (MA)   |
| Numri i orëve në javë:          | 2+0   |
| Kreditë ECTS:                   | 6   |
| Koha / Vendi:                   | Sipas orarit  |
| Mësimdhënësi:                   | Prof.ass.dr. Kadire Binaj - Ejupi   |
| Të dhënat kontaktuese:          | <a href="mailto:kadire.binaj@uni-pr.edu">kadire.binaj@uni-pr.edu</a>  |
| Përshkrimi i lëndës:            | <p>Lënda Gjuhësi ballkanike trajton elementet e përbashkëta gjuhësore ballkanike, diskuton historinë e kontaktit dhe të bashkëjetesës dhe ndërndikimet gjuhësore në periudha të ndryshme.</p> <p>Ballkani është një truall gjeografik, në të cilin popuj të ndryshëm kanë jetuar në kontakt të afërt për shekuj të tërë. Ky kontakt i vazhdueshëm ka krijuar konvergjenca të dukshme gjuhësore. Si rezultat i kësaj janë krijuar një sërë elementesh gjuhësore të përbashkëta për këto gjuhë dhe këto ngjashmëri kanë krijuar mes studiuesve idenë për Lidhjen gjuhësore ballkanike, apo siç njihet Sprachbund-i Ballkanik. Në kuadër të Sprachbund-it hyjnë gjuhë të tilla si shqipja, dialekte të serbishtes e kroatishtes, bullgarishtja, maqedonishtja, greqishtja dhe rumanishtja.</p> |
| Qëllimet e lëndës:              | <p>Ky kurs synon të ofrojë bazën teorike të Sprachbund-it Ballkanik, duke ofruar një panoramë të gjuhëve që e përbëjnë Sprachbund-in, duke i dalluar elementet e përbashkëta, duke e analizuar kontaktin që i ka krijuar ato elemente të përbashkëta dhe duke ofruar një sfond të përgjithshëm kulturor.</p>  |

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Në fund të këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:

- të krijojë një pasqyrë të historikut të kontakteve gjuhësore në Ballkan;
- të njohë gjuhët që përbëjnë Sprachbund-in Ballkanik, sfondin e përgjithshëm të tyre dhe kontaktet mes tyre në histori dhe tani;
- të njohë bashkëpërkimet kryesore të fushës së fonetikës, të leksikut dhe të gramatikës;
- të njohë elementet kryesore të tipologjisë gjuhësore;
- të njohë studimet dhe studiuesit kryesorë që kanë kontribuar në këtë fushë;
- të sqarojë dukuri të caktuara gjuhësore të shqipes duke i krahasuar me dukuritë e njëjta në ndonjërin nga gjuhët ballkanike.

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

| Aktiviteti                                      | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej                           |
|---|--------------|-----------|------------------------------------|
| Ligjëratat                                      | 2            | 15        | 30                                 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime                 |              |           |                                    |
| Punë praktike                                   |              |           |                                    |
| Përgatitje për test intermediary                |              |           |                                    |
| Konsultime me mësimdhënësin                     | 12 min       | 15        | 3                                  |
| Puna në terren                                  |              |           |                                    |
| Testi, punimi i seminarit                       | 1            | 15        | 15                                 |
| Detyrë shtëpie                                  | 2            | 3         | 6                                  |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 3            | 15        | 45                                 |
| Përgatitja për provimin final                   | 2            | 15        | 30                                 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 2            | 2         | 4                                  |
| Projektet, prezantimet, etj.                    | 2            | 2         | 4                                  |
| <b>Total</b>                                    |              |           | <b>138: 25=<br/>5.52<br/>6ECTS</b> |

|                         |   |
|-------------------------|---|
| Metodat e mësimdhënies: | Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe detyrave që realizohen me punë në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi. Studentët obligohen të përgatitin dhe të prezantojnë një seminar me shkrim nga kjo lëndë.   |
| Metodat e vlerësimit:   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Punimi i seminarit 50%</li> <li>- Pjesëmarrja 10%</li> <li>- Prezantimi i punimit 10%</li> <li>- Testi teorik 30%</li> <li>- Gjithsej 100%</li> </ul>  |
| P                       | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ismajli, Rexhep. 2018. Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik. Prishtinë, ASHAK</li> <li>2. Rexhep Ismajli (redaktor), 2012. Shqipja dhe gjuhët e ballkanit, Konferencë shkencore, Prishtinë: ASHAK</li> <li>3. Demiraj, Shaban. 2004. Gjuhësi ballkanike. Tiranë: ASHSH</li> <li>4. Bokshi, Besim. 2009. Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike, Tiranë: ASHSH</li> </ol>   |
| Literatura shtesë:      | <ol style="list-style-type: none"> <li>5. Friedman, Victor. 2003. Studies on Albanian and Other Balkan Languages. Pejë: Dukagjini</li> <li>6. Todorova, Maria. 2009. Imagining the Balkans, Oxford University Press</li> <li>7. Assenova, Petya. 2002. Balkansko ezikoznanie, V. Ternovo.</li> <li>8. Sandfeld, Christian. 1930. Linguistique balkanique, Paris.</li> <li>9. Banfi, Emanuele. 1985. Linguistica Balkanica, Bologna.</li> <li>10. Jashar – Nasteva, Olivera. 1998. Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike, Shkup: Logos -A</li> </ol> |

| Hartimi i planit mësimor |  |
|--------------------------|--|
| Java                     | Titulli i ligjëratës   |
| Java 1:                  | Prezantimi i silabusit<br>Hyrje në gjuhësinë ballkanike  |
| Java 2:                  | Gjuhësia ballkanike dhe zhvillimi i saj; Dukuritë e përbashkëta gjuhësore të gjuhëve ballkanike; Kontributi i autorëve të ndryshëm për problemet e gjuhësisë ballkanike. |
| Java 3:                  | Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik në lashtësi I; Popujt dhe gjuhët që fliteshin në Gadishullin Ballkanik para dyndjes së fiseve indoevropiane.                   |

|          |  |
|----------|--|
| Java 4:  | Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik në lashtësi II; Popujt dhe gjuhët që fliteshin në Gadishullin Ballkanik para dyndjes së fiseve indoevropiane.  |
| Java 5:  | Gjendja e sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik I; Gjuhët që fliten sot në Gadishullin Ballkanik: Shqipja, vendet ku flitet ajo dhe dukuritë kryesore ballkanike të gjuhës shqipe;  |
| Java 6:  | Gjendja e sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik II; Gjuhët që fliten sot në Gadishullin Ballkanik: Greqishtja e re, vendet ku flitet ajo dhe dukuritë kryesore ballkanike të greqishtes së re. Rumanishtja, vendet ku flitet ajo dhe dukuritë kryesore ballkanike të rumanishtes. |
| Java 7:  | Gjendja e sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik III; Gjuhët që fliten sot në Gadishullin Ballkanik: Gjuhët sllave të Ballkanit, vendet ku fliten ato dhe dukuritë kryesore ballkanike të secilës prej tyre.   |
| Java 8:  | Dukuritë gjuhësore të përbashkëta në fushën e fonetikës  |
| Java 9:  | Dukuria e reduktimit të rasave në gjuhët ballkanike  |
| Java 10: | Prapavendosja e nyjës shquese  |
| Java 11: | E ardhmja perifrastike me <i>do</i>  |
| Java 12: | Rimarrja e kundrinave  |
| Java 13: | Zëvendësimi i paskajores me lidhoren   |
| Java 14: | Disa veçori të tjera të përbashkëta të gjuhëve ballkanike: 'mënyra lokative' e numërimit; krahasimi analitik; sistemi i komplikuar foljor  |
| Java 15: | Bashkëpërkime midis shqipes e rumanishtes  |

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.